Kronikë

Hodhi nga makina çantën ku mbante armën dhe tentoi të ikte me vrap nga policia arrestohet 19-vjeçari në Vlorë! Në pranga edhe një tjetër

Një 19-vjeçar i cili lëvizte me armë zjarri pistoletë me silenciator në makinë është arrestuar në flagrancë nga policia e Vlorës.

Arma e zjarrit e sekuestruar

Redaksia
3 Prill, 12:13 | Përditësimi: 3 Prill, 12:18

Share

Vlorë- Një 19-vjeçar i cili lëvizte me armë zjarri pistoletë me silenciator në makinë është arrestuar në flagrancë nga policia e Vlorës.

Në pranga ka rënë edhe drejtuesi i automjetit, 34 vjeç për moskallëzim krimi.

Sipas njoftimit të bluve, raportohet se dy të rinjtë u kapën një natë më parë pas një kontrolli rutinë në makinën 'Benz' që ata po udhëtonin në aksin rrugor "Orikum-Vlorë".

LEXO EDHE:
KPA rrëzon KPK-në, shkarkon nga detyra gjyqtaren e Vlorës Mirela Mishgjoni

Pas ndërhyrjes së policisë i riu ka hedhur çantën ku mbante armën dhe më pas ka tentuar të arratiset, por pa sukses.

Si provë materiale u sekuestrua arma e zjarrit.

Operacioni u kodua 'Nightfall'.

Njoftimi i policisë:

Në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të armëmbajtjes pa leje, Sektori për Hetimin e Krimeve të Rënda i DVP Vlorë, në bashkëpunim me Seksionin për Mbështetjen Operacionale të Hetimit, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Nightfall".

Gjatë këtij operacioni, në mbrëmje, në aksin rrugor "Orikum-Vlorë", në Radhimë, është ndaluar për kontroll një automjet tip "Mercedes Benz" me të cilin qarkullonin 2 shtetas. Në momentin e ndërhyrjes së Policisë, pasagjeri ka hedhur nga automjeti një çantë dhe ka tentuar të largohet me vrap, por është kapur menjëherë nga shërbimet e Policisë.

Gjatë kontrollit në çantën marsup, u gjet një armë zjarri pistoletë me silenciator, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vlorë arrestuan në flagrancë shtetasit:

P. K., 19 vjeç, banues në Orikum, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit";

B. K., 34 vjeç, banues në Orikum, për veprën penale "Moskallëzim i krimit".

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Vlore | arme zjarri

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
3 Prill, 11:51
Trump tarifa doganore 10 për qind Shqipërisë, sa ndikon në ekonomi?
Shumë | Pak | Nuk e di

Lajme të tjera

Zhupa kërkon mbylljen e zyrës zgjedhore të PS në Delvinë: Shkelje zgjedhore, ndodhet 50 metra larg KZAZ-së! Kërkesa depozitohet në KQZ
3 Prill, 14:33

FOTO/ Ky është mishi i pulës me salmonelë që treqtohet në markete, AKU thirrje qytetarëve: Nëse e keni blerë, kthejeni!
3 Prill, 12:24

Në kërkim për armëmbajtje pa leje dhe lojëra fati, arrestohet 41-vjeçari në Morinë (EMRI)
3 Prill, 09:52

Vlorë/ Policia Rrugore në aksion kundër shoferëve 'rebelë', drejtori Çela në krye të operacionit, të shoqëruar dhe të gjobitur (VIDEO)
2 Prill, 23:05

Një nga ne/ Njihuni me Shpëtimin, marangozin që këndon labçe: E kemi në gen, nuk i harrojmë rrënjët
Xhensila Nako
2 Prill, 20:48

Bledi Çuçi nga Vlora: Oferta e PD në këtë qytet është Saliu i '97-ës dhe Bujari i 2005-ës! Ambicia e PS, të marr 9 mandate në këtë qark
2 Prill, 20:07

Vlorë/ Qytetarët gjejnë portofolin me para dhe karta, e dorëzojnë në polici
2 Prill, 10:44

Berisha e akuzoi për falsifikim dokumentesh, Bido: E kam nxjerr blof me fakte! Fitorja e PS do sjellë anëtarësim në BE, Greqia s'mund ta bllokojë procesin e integrimit
1 Prill, 20:20

Plagosi me thikë bashkëshorten në Sarandë, arrestohet 55-vjeçari! Fqinjët: Janë familje e qetë
Limos Didani
1 Prill, 13:44

Gjenden 43 bidonë me karburant afër Sazanit, dyshohet se i hodhi një skaf gjatë ndjekjes, vinte nga Greqia! Policia: U kontrolluan 200 mjete lundruese (VIDEO)
1 Prill, 11:46

Rama e la në listën e hapur, Çuçi prezanton Gjiknurin: Objektivi ynë është 9 mandate Vlorë, kemi mundësinë historike
1 Prill, 11:14

Maliq/ Gjenden 3 armë zjarri të mbështjella me qese plastike! Ja çfarë thotë policia
1 Prill, 10:52

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje